





REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <b>2-D/DPK</b>	Nr Prot. Br Prot Prot No. <b>01-1159/14</b>
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages <b>02</b>	Data Datum Date <b>28.03.2014</b>
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

DATË/A:	28.03.2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Selami BERISHA Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik
CC:	z. Nazmi ZENELAJ Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull "Laboratori i Institutit Gjeologjik të Kosovës "



**I nderuari z. BERISHA,**

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Laboratori i Institutit Gjeologjik të Kosovës ", me nr. të prokurimit: 43900-014-003-111, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

**OPINION**

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Laboratori i Institutit Gjeologjik të Kosovës " në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04-L/042 për Prokurimin Publik.

**A r s y e t i m**



Ministria e Zhvillimit Ekonomik si Autoritet kontraktues, përmes Zyrës së Prokurimit ka përgatitë “Njoftimin për Kontratë” me titull “ Laboratori i Institutit Gjeologjik të Kosovës “ me nr. prokurimi:43900-014-003-111, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt. 21.02.2014, në Procedurë të Hapur. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, pranë Agjencisë kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë procedurë prokurimi si rast për trajtim. Gjatë ekzaminimit të dokumentacionit për këtë aktivitet të prokurimit në “Njoftimin për Kontratë” dhe “Dosjen e Tenderit“, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me Procedurat e Prokurimit të cilat rregullohen me ligjin për Prokurimin Publik i cili është i zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

Agjencia kundër Korrupsionit, konstaton qartë se Autoriteti Kontraktues Ministria e Zhvillimit Ekonomik këtë aktivitet të prokurimit e ka klasifikuar si Kontratë për Furnizim, ndërsa nuk e ka paraparë tek pozicioni i Kontratave për furnizim në Planifikimin e Prokurimit për vitin 2014.

Gjatë ekzaminimit të dokumentacionit për këtë Tender, tek pjesa e specifikimeve teknike të detyrueshme në Dosjen e Tenderit faqe 47, tek pjesa vërejtje: pika d) është kërkuar që pajisjet duhet të jenë me origjinë nga UE (Unioni Europian). Me formulimin e këtyre specifikimeve teknike është cekur origjina e pajisjeve. Me përcaktimin e origjinës të këtyre pajisjeve, favorizohen prodhuesit e caktuar dhe në të njëjtën kohë diskriminohen prodhuesit tjetër që janë jashtë Unioni Europian. Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që produkti të jetë i kualitetit të lartë dhe mund ti referohet një standardi vendor, Europian ose ndërkombëtar, por nuk lejohet assesit të kërkojë që origjina e këtyre pajisjeve të jetë nga UE.

Autoriteti kontraktues duhet t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Gjatë ekzaminimit dhe krahasimit të dokumentacionit për këtë aktivitet të prokurimit lidhur me rubriken Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare dhe rubriken Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale “Njoftimit për Kontratë” dhe “Dosjes së Tenderit” mund të vërehet shumë qartë se Kriteret e përzgjedhjes të këto rubrika të cilat janë caktuar, nuk janë identike çka paraqet mospërputhje në mes Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me **nenin 7** Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe **nenin 8** Planifikimi i Prokurimit dhe **nenin 27** Dosja e Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !